



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 13.12.2022

NR.09/ 10129 /2022

KONTRATË SHERBIMI

Numri i kontratës¹: 659-22-13643-2-4-7; KKHE-22-049-247

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
AUTO SERVIS AGRONI SHPK, Hani i Elezit, 810155392, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën
tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:
MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE TË ZJARRFIKËSAVE me numër identifikues:
659-22-13643-2-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

No.	Lot
1	MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE TË ZJARRFIKËSAVE

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 900.00 Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka
borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të detyrues së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të
paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe
transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	XHEVOET BUSHI
Pozita:	Shefi i Zyrtarëve
Nënshkrimi:	
Data:	13.12.2022
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Driton Thaci
Pozita:	Prokuror
Nënshkrimi:	
Data:	13.12.2022
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-22-3538-2-4-7/C252

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

~~Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënimet kurstive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Eshini ato jo relevante.~~

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi E Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 13.12.2022
	6.4	Data e Përfundimit është 12.02.2023
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është HANI I ELEZIT
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është N/A
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pas përfundimit të shërbimeve, me raport do të bëhet pagesa.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Periudha Garantuere e Defekteve është 3 muaj
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Me mirekuptim në mes të Komunes – DSHPE dhe Kontraktuesit, në të kundërt do të bëhet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me gjykatë!
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregut, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregut Ndërkombëtar, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtare)].